

## ARTIKUJT E BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK 2009

PËRCAKTUESIT E MARZHIT NETO TË INTERESAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR Mars 2009  
Irimi Kalluci

Ky material trajton marzhin neto të interesave si një matës i eficiencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar dhe fokusi kryesor është në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në masën e këtij treguesi. Marzhi neto i interesave mund të llogaritet si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve apo me aktivet që sjellin të ardhura. Megjithatë, një reduktim i këtij treguesi jo në të gjitha rastet sinjalizon përmirësim efieencie. Në këto kushte, studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë ndryshime në kostot e ndërmjetësimit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj. Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sistemit financiar shqiptar, aktivet e të cilit zënë rreth 97 për qind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. Për rastin e Shqipërisë, bankat funksionojnë si aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhënësit te huamarrësit, prandaj është e rëndësishme që roli ndërmjetësues i tyre të sigurojë një mirëqenie më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Në këtë kontekst mori fillësën edhe ky studim, duke synuar që nëpërmjet tij të identifikohen faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave për sistemin bankar shqiptar dhe duke shpresuar që do të kontribuojë në literaturën e shkruar rreth kësaj çështjeje, meqenëse një studim i tillë realizohet për herë të parë për rastin e Shqipërisë. Grupe të ndryshme interesi, por sidomos politikëbërësit janë të interesuar në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve bankare që gëzojnë stabilitet dhe efieencie. Stabiliteti kërkon kthime të mjaftueshme, ndërsa efieencia ekonomike kërkon marzhe në nivele të pranueshme, të aplikuara nga bankat. Rezultatet e marra nga analiza e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, mund të jenë të dobishme për hartimin e masave specifike të politikave ekonomike.

REZERVA VALUTORE NË SHQIPËRI: MATJA DHE NIVELI I NJË ANALIZE KRAHASUESE ME VENDET E RAJONIT  
Olta Manjani

Ky material synon të paraqesë një përshkrim të përgjithshëm të treguesve për mbajtjen e rezervës valutore nga autoriteti monetar. Strategjia e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rezervës valutore parashikon rritjen e vazhdueshme të saj në përputhje me tiparet kryesore të ekonomisë: deficit i lartë dhe në rritje i llogarisë korrente, rritje e shpejtë e borxhit të jashtëm afatshkurtër si dhe zhvendosje e theksuar e parasë së gjerë drejt përbërësit të

saj valutore. Në këto kushte, aplikimi i kriterëve të mjaftueshmërisë për matjen e rezervës valutore duhet të mbajë parasysh kriteret e tilla si mbulimi me rezervë në vlerë i 3 - 4 muajve importe mallrash dhe shërbimesh, mbulimi me rezervë në vlerë i një ose mbi një vit i borxhit të jashtëm afatshkurtër apo mbulimi me rezervë nga 5 deri në 20 për qind të sasisë së parasë së gjerë. Zbatimi i këtyre kriterëve, përveçse shërben për t'u paraprirë faktorëve potencialë të rreziqeve që mund të çenojnë ekonominë shqiptare, gëzon një shkallë të lartë kredibiliteti dhe siguron një bazë të mirë krahasuese midis vendeve të ndryshme.

Qershor 2009

#### KRIZA FINANCIARE DHE VENDET E RAJONIT

Eglent Kika, Erblin Maçi, Medvin Shehu

Ky artikull synon të paraqesë një retrospektivë të evoluimit të krizës financiare prej vendeve të zhvilluara në vendet në zhvillim ku në fokus janë disa prej vendeve të Evropës Qendrore, disa prej vendeve të rajonit dhe Shqipëria. Në këtë kontekst, interes i veçantë i kushtohet mënyrës së reflektimit të krizës në treguesit realë të këtyre ekonomive si dhe lëvizjet fiskale, monetare apo operacionale të institucioneve përkatëse sipas profilit ekonomik të secilit vend.

#### MATJA E PRITSHMËRIVE TË INFLACIONIT

Gent Hashorva, Elona Bollano, Elvana Troqe

Në këtë material, autorët janë përpjekur të zbatojmë disa teknika të kuantifikimit të përgjigjeve të mbledhura nëpërmjet Vrojtimit të Besimit të Konsumatorit, që kryhet nga Banka e Shqipërisë. Në të njëjtën kohë bëhen përpjekje për të kuptuar më mirë natyrën e pritjeve të konsumatorëve shqiptarë. Materiali është i organizuar si vijon: Në seksionin e parë zbatohet metodologjia dhe testet në rastin e Shqipërisë. Seksioni i dytë trajton rëndësinë e pritjeve në procesin e kontrollit të inflacionit dhe mënyrën e matjes së tyre. Seksioni i tretë vijon me metodologjinë e konvertimit të të dhënave nga cilësore në sasiore, duke përdorur disa lloje funksionesh të metodës së kuantifikimit probabilitar si dhe trajtohen testet e treguesit të inflacionit të pritur, për të arritur në konkluzione në lidhje me natyrën e pritjeve të konsumatorëve. Materiali mbyllet me disa konkluzione paraprake.

Shtator 2009

#### ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

Erjona Suljoti, Sofika Note

Sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 16 banka universale, private dhe ku dominon dukshëm kapitali i huaj, i cili përbën rreth 92% të kapitalit të mbajtur të sistemit bankar. Ndonëse një numër jo i vogël bankash kanë qenë të pranishme në Shqipëri që prej vitit 2000, aktiviteti i mirëfilltë ndërmjetësues i sistemit bankar ka marrë hov në 4-5 vitet e fundit. Ndërmjetësimi financiar

i bankave deri në vitin 2004 karakterizohej nga grumbullimi i kursimeve të agjentëve ekonomikë dhe nga mobilizimi i ulët i tyre në kredidhënie, veçanërisht për sektorin privat. Ndërkohë, financimi i borxhit publik përbënte 55% të aktiveve, duke dëshmuar mobilizimin e lartë të fondeve drejt sektorit publik. Kjo tablo e aktiveve të sistemit bankar ishte pasojë e shtrirjes së ulët gjeografike të sistemit bankar, rrezikut më të lartë të kredidhënies, integritimit më të ulët të sektorit real me sistemin bankar si dhe e elementeve rregullative mbikëqyrëse prezente në atë kohë.

#### REZULTATET E VROJTIMIT PRANË FAMILJEVE PËR TË ARDHURAT NGA EMIGRANTËT (VITI 2008) Godiva Rëmbeci

Studimi ofron informacion mbi karakteristikat e përgjithshme të familjeve që përfitojnë dërgesa nga emigrantët, karakteristikat e emigrantëve dhe të ecurisë së dërgesave të tyre në Shqipëri, në bazë të të dhënave të vrojtimeve tremujore të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2008. Rezultatet e këtyre vrojtimeve janë jo vetëm një burim i mirë informacioni për të plotësuar dhe në një të ardhme, zëvendësuar vlerësimin për dërgesat nga emigrantët në bilancin e pagesave, por ato mund të përdoren si seri kohore nga analistët për të ndjekur, kuptuar dhe parashikuar fenomenin e dërgesave në kriteret më kryesore të tij.

#### ZHVILIMI FINANCIAR DHE RITJA EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË Elona Dushku

Ky material investigon lidhjen shkak-pasojë midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke përdorur testin e Granger-causality për pesë tregues të ndryshëm të zhvillimit financiar. Kështu, për seritë që nuk janë as stacionare, as të kointegruara është ndërtuar modeli VAR dhe më pas është aplikuar testi i mësipërm. Ndërsa, për seritë jo stacionare, por që midis tyre gjendet një lidhje kointegruese, testi i Granger-causality është aplikuar pas ndërtimit të vector error correction model (VECM). Gjetjet empirike të këtij materiali tregojnë, që në afatin e gjatë vërtetohet lidhja pozitive midis të gjithë treguesve që matin zhvillimin financiar dhe rritjes ekonomike. Ndërsa, në afatin e shkurtër kjo lidhje nuk është mjaft e qartë, pasi tregues të ndryshëm japin rezultate të ndryshme. Të dhënat që analizuam i përkasin periudhës 1996-2007.